



# FORÇA JONË

\* \* \* Viti I • Nr. 4 • Shtator 2012 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës \* \* \*

## Shtetet e Bashkuara të Amerikës do të vazhdojnë ta përkrahin zhvillimin e FSK-së

Ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës Agim Çeku është siguruar nga zyrtarët më të lartë të administratës amerikane se SHBA-të janë të përkushtuara për zhvillimin e mëtejshëm të FSK-së. Në ditën e parë të vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së Kadri Kastrati të shoqëruar nga ambasadori Akan Ismaili dhe atasheu i Forcës së Sigurisë, gjeneral brigade Xhavit Gashi u pritën nga zyrtarët më të lartë të Departamentit të Mbrojtjes, Departamentit të Shtetit si dhe të Shtëpisë së Bardhë. Delegacioni i parë nga ministri Agim Çeku pati takime të ndara në Pentagon, me zëvendës-nënësekretaren e parë të Mbrojtjes për Politika, Dr. Kathleen Hicks, gjeneralin Craig R. McKinley, shefen e Zyrës së Gardës Kombëtare

Amerikane, RDML Mark Montgomery, udhëheqës i zyrës për Evropën Perëndimore dhe Ballkanin, si dhe zëvendës-ndihmës sekretarin e mbrojtjes për Partneritet Strategjik dhe Operacione Stabiliteti, z. James Schear. Delegacioni i Kosovës në kuadër të vizitës në Uashington, ka realizuar takime edhe në Departamentin e Shtetit, ku u takua me ambasadorin Philip Reeker, zëvendës-ndihmës sekretar i SHBA-ve për Evropë. Ndërsa në Këshillin Kombëtar për Siguri Kombëtare pranë Shtëpisë së Bardhë, ministri Çeku dhe delegacioni i Kosovës zhvilluan një takim edhe me Dr. Liz Sherwood-Randal. Në takimet që pati ministri Agim Çeku ka falënderuar bashkëbiseduesit për përkrahjen e vazh-



dueshme të SHBA-ve, për Kosovën dhe për FSK-në, prezantoi të arriturat e FSK-së, vizionin dhe objektivat strategjike të saj, si dhe kërkoi vazhdimin e përkrahjes së SHBA-ve, përmes partneritetit me Gardën Nacionale të Ajavës dhe programeve tjera prej të cilave përfiton FSK-ja. Në veçanti u bisedua për

procesin e rishikimit të Sektorit Strategjik të Sigurisë si hap i rëndësishëm në zhvillimin e mëtejshëm të FSK-së. Ministri Agim Çeku gjithashtu kërkoi përkrahjen e SHBA-ve në integrimin e FSK-së në nisma rajonale dhe në procese integruuese euro-atlantike.

Në të gjitha takimet, zyrtarët e lartë amerikanë shprehën mirënjohjen për të arriturat e FSK-së, për punën e lidershit të saj dhe nxitën përkushtimin e mëtejshëm në arritjen e objektivave strategjike duke siguruar përkushtimin e SHBA-ve për një përkrahje të vazhdueshme për zhvillimin e FSK-së.

## Ajova dhe Kosova konfirmuan bashkëpunimin për të ardhmen në shumë fusha



Në shtetin Ajova të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka përfunduar punimet Konferenca për Programin Shtetëror të Bashkëpunimit ndërmjet shtetit të Ajavës dhe Kosovës. Gjatë qëndrimit në Ajovë, ministri dhe komandanti i FSK-së, Agim Çeku dhe gjeneral Kastrati zhvilluan një varg takimesh me rëndësi dhe me interes për Forcën e Sigurisë të Kosovës. Gjithashtu edhe oficerët e FSK-së së bashku me opozitët e Gardës Kombëtare të Ajavës, gjatë qëndrimit të tyre në Ajovë, shkëmbyen eksperiencën në shumë fusha ushtarake si edhe patën rastin të njihen nga afër dhe të vizitojnë: Qendrën Stërvitore, Qendrën Simulative si edhe Qendrën e Situatave të Komandës së Gardës Kombëtare të Ajavës.

Gjatë konferencës punuan edhe grupet punuese me panele profesionale të cilat ishin funksionale dhe praktike, në kuptimin më të mirë të gjendjes së sigurisë, gjendjes politike dhe sociale në Kosovë. Konferenca treditore ishte e përqendruar në planet dhe synimet për të ardhmen në kuadër të Programit Shtetëror të Partneritetit Ajovë-Kosovë. Me këtë rast u konfirmua edhe bashkëpunimi për të ardhmen në mes dy vendeve. Kështu në shtator të këtij viti, Ministrinë dhe Forcën e Sigurisë të Kosovës do ta vizitojë një delegacion i lartë ushtarak dhe civil nga Ajova, në krye me gjeneral-majorin Timoti Orr, komandant i Gardës Kombëtare të shteti Ajova, të SHBA-ve.

## Komandanti i KFT-së, gjeneral Rahman Rama, kthehet nga SHBA-ja pas një trajnimi gjashtëmuor

Zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneralmajor Rahman Rama, filloi punën dhe detyrat e përditshme pas përfundimit të trajnimit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjeneralmajor Rahman Rama ka përfunduar me sukses trajnimin

gjashtëmuor, të filluar në shkurt të këtij viti, në bazën ushtarake të Forcave Ajrore në San Antonio të shtetit Teksas, në SHBA. Pas një periudhe gjashtëmuore larg ushtarëve dhe oficerëve të FSK-së, gjeneralmajor Rahman Rama, pas kthimit, është takuar me stafin e KFT-së, ku është njoftuar me zhvillimet në Komandën e Forcave

Tokësore dhe njësitë e saj, përgjatë kohës sa ka qëndruar në trajnim, në Amerikë. Gjeneral Rahman Rama ka theksuar se trajnimi i tij, në SHBA, ishte me mjaft interes dhe i rëndësishëm së madhe. Po ashtu vëmendje të veçantë i ka kushtuar bashkëpunimit të FSK-së me SHBA-në dhe rolin që kanë SHBA-të në zhvillimin e FSK-së.





# FSK-ja mbajti ceremoni lamtumirëse për komandantin e KFOR-it, gjeneralin Erhard Drews

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka organizua një ceremoni lamtumirëse për komandantin e KFOR-it, gjeneralin Erhard Drews, para se të largohet nga Kosova.



Komandanti i KFOR-it gjenerali Erhard Drews u prit nga ministri i MFSK-së Agim Çeku, komandanti i FSK-së gjeneralletenant Kadri Kastrati, zëvendësministri: Shemsi Veseli, Bejtush Gashi dhe Sllavisha Filipoviq, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylja, gjeneralë dhe oficerë të lartë të FSK-së, përfaqësuesit e Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrje të FSK-së të Kuvendit të Kosovës të kryesuar nga Ahmet Isufi, përfaqësuesit e KFOR-it, këshilltarë të Ekspit Ushtarak Këshillues të NATO-s në FSK, si dhe atashetë ushtarake të akredituar në Kosovë.

Komandanti i KFOR-it u prit me nderime ushtarake nga njësia ceremoniale dhe kuadratet e FSK-së.

Komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Kadri Kastrati e ka dekoruar komandantin e KFOR-it, gjeneralin Drews, me medaljen "Arritje e dalluar" me motivacionin për performancë të shkëlqyeshme gjatë kryerjes së detyrës ushtarake si komandant i KFOR-it dhe për mbështetje të jashtëzakonshme ndaj FSK-së"

Komandanti i FSK-së gjeneralletenant Kadri Kastrati, në ceremoninë lamtumirëse të organizuar nga FSK-ja, mbajti fjalën e rastit, ku, pos tjerash, tha:

"Jemi tubuar në këtë ceremoni lamtumirëse me rastin e kryerjes së detyrës së komandantit të KFOR-it,

gjeneralit Drews.

Që nga themelimi FSK-ja ka pas mbështetjen e fuqishme dhe të pa rezervë të KFOR-it dhe ky bashkëpunim ka vazhduar gjatë tërë procesit të ngritjes dhe trajnimit të FSK-së.

### ***I nderuar gjeneral Drews!***

Gjatë mandatit Tuaj, ju jeni angazhuar me përkushtim të lartë për krijimin e një ambienti të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës. Prania Juaj në ushtrimet fushore të FSK-së ka qenë inspirim për realizimin profesional të ushtrimeve tona. Puna Juaj në kuadër të bashkëpunimit ka bërë avancime të dukshme në FSK dhe falë këtij bashkëpunimi, sot, FSK-ja është shumë më e përgatitur se para një viti. Ju në cilësinë e komandantit të KFOR-it i keni raportuar NATO-s dhe Brukselit, për plotësimin e kapaciteteve operacionale të FSK-së. Ju keni vlerësuar realisht ngritjen, zhvillimin dhe nivelin e kapaciteteve operuese e profesionale të FSK-së.

Ju i keni besuar FSK-së shumë detyra profesionale, të cilat FSK-ja, sot, po i kryen me sukses dhe përkushtim. Në zhvillimin e bashkëpunimit civil-ushtarak, Ju keni bërë çdo gjë që të ndihmohet FSK-ja, t'i jepet mundësia që ajo të marrë pjesë në rindërtimin e jetës dhe vendit. Ky bashkëpunim e ka forcuar besimin mes dy institucioneve tona dhe na ka ndihmuar në rrugën

tonë drejt plotësimin të standardeve dhe ngritjes së kapaciteteve të plota operacionale.

Edhe pse jemi dy struktura të ndryshme dhe të pavarura, është e qartë se FSK-në dhe KFOR-in i bashkon qëllimi i njëjtë: Të ndërtojmë paqen dhe sigurinë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

### ***Të nderuar miq!***

Siguria e qëndrueshme është objektivi më i rëndësishëm për shtetin e Kosovës dhe FSK-në, si kontribut dhe objektivi i përbashkët i shteteve të rajonit dhe më gjerë.

FSK-ja e ngritur me një strukturë profesionale dhe sipas standarde të avancuara të NATO-s, do të jetë kontribuues aktiv, në funksion të paqes dhe të zhvillimit demokratik të Kosovës, duke e shndërruar Kosovën nga konsumues në kontribuues të paqes.

Prandaj, Bashkësia Ndërkombëtare, NATO dhe KFOR-i, duhet ta konsiderojnë sukses të vërtetë të tyre, ndërtimin e kapaciteteve të plota të FSK-së. Duhet ta vlerësojmë si histori të suksesit tonë të përbashkët. FSK-ja ka treguar pjekuri dhe profesionalizëm duke i ndihmuar të gjithë qytetarët e Kosovës, gjë që e ka rritë shumë besimin tonë si institucion tek publiku vendorë dhe miqtë tanë ndërkombëtarë.

### ***Shumë i nderuar gjeneral Drews!***

Ju siguroj se, ne, do të vazhdojmë të punojmë në këtë drejtim me të gjitha energjitë që kemi, së bashku edhe me pasardhësin Tuaj.

Të jeni të bindur se përpjekjet Tuaja, kanë qenë produktive dhe ju premtoj se FSK-ja, do të jetë gjithmonë e përkushtuar për t'i kontribuar paqes dhe stabilitetit.

Duke ju uruar gjithë të mirat në jetë dhe suksese të reja në karrierën tuaj ushtarake, Ju siguroj se as Ju e as puna Juaj nuk do të harrohen.

Edhe një herë suksese dhe faleminderit".

### **Fjala e komandanti të KFOR-it, gjeneralit Drews**

## **Ju do t'i vendosni standardet për të ardhmen e FSK-së**

"Është nder i madh për mua të pranoj këtë medalje sot dhe dëshiroj të ju falënderoj juve për konsideratën e lartë ndaj meje. Këtë dhuratë që po ma jepni sot, e pranoj me plot respekt në emër të ushtarëve të mi që kanë punuar pa u lodhur për Kosovën. Si komandant i KFOR-it, jam i bekuar që kam pasur nderin dhe privilegjin të udhëheq një forcë profesionale dhe të aftë.

Që nga fillimi i vitit 2009, FSK-ja vazhdimisht ka përparuar, duke zgjedhur dhe trajnuar individë cilësorë nga kultura të ndryshme. Dhe sot, qëndron e gatshme për të përmbushur misionin duke reaguuar shpejtë dhe duke i ndihmuar autoritetet civile në katastrofat natyrore apo në emergjencat tjera.

FSK-ja ka vazhduar ta forcojë reputacionin e saj si një forcë profesionale përmes udhëheqjes, standardeve të larta dhe trajnimeve cilësore, që e kanë ndërtuar këtë forcë të jashtëzakonshme që e shohim këtu. Ju përgëzoj të gjithëve për një punë të kryer mirë dhe puna juaj drejtpërdrejt ka efekt në respektimin e



Kosovës:

Gjenerali Drews, më tej, shtoi: Të gjithë ju bartni një përgjegjësi të rëndë si pjesëtarët e parë që po i ndërtoni themelet e forta për të ardhmen e FSK-së e që gjithsesi do të formoni të ardhmen e Kosovës për gjeneratat që do të vijnë.

Nga perspektiva ime, Kosova ka bërë arritje të mëdha në përmirësimin e jetës së qytetarëve të saj dhe FSK-ja ka qenë pjesë e këtij përparimi. Edhe pse ka shumë ngjarje pozitive, njëra prej tyre mbetet e veçantë në mendjen time dhe që gjithmonë do ta kujtoj, ka qenë intervenimi i FSK-së, në Restelicë.

Ju keni zgjedhur një rrugë të shërbimit publik dhe gjatë shërbimit tuaj, do t'i vendosni standardet për të ardhmen e FSK-së. Vendosi standarde më të larta dhe bëni që veprimet e juaja të formësojnë reputacionin tuaj dhe të FSK-së.



## **Pritje në MFSK e ambasadores së Turqisë dhe këshilltarit ushtarak kolonel Yucel Keles**

Ministri i MFSK-së Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjeneralletenant Kadri Kastrati kanë pritë në vizita të ndara lamtumirëse, në Ministrinë e FSK-së, në përfundim të mandatit, këshilltarin ushtarak të ministrit dhe komandantit të FSK-së, kolonelin e Ushtrisë së Turqisë Yucel Keles të shoqëruar nga

ambasadorja e Turqisë Songul Ozan.

Me këtë rast, ministri dhe komandanti i FSK-së, kanë vlerësua lartë bashkëpunimin me Ministrinë e Mbrojtjes së Turqisë dhe Ushtrinë e Turqisë, duke falënderuar shtetin turk, për bashkëpunimin e deritanishëm si dhe gatishmërinë për të thelluar

edhe më shumë këtë bashkëpunim.

Ministri Agim Çeku, në fund, e ka dekorua atashëun ushtarak turk, Yucel Keles me medaljen "Për shërbim të merituar". Ndërsa, komandanti i FSK-së gjeneral Kadri Kastrati, atashëun ushtarak turk i ka dhënë medaljen, për "Arritje të jashtëzakonshme".

## U mbajt Konferenca për Programin Shtetëror të Bashkëpunimit Ajovë - Kosovë

Në shtetin Ajova të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për tri ditë me radhë është mbajtur Konferenca për Programin Shtetëror të Bashkëpunimit ndërmjet shtetit të Ajovës dhe Kosovës.

Në konferencë kanë marrë pjesë ministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës Agim Çeku, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, oficerë dhe zyrtarë të lartë të MFSK-së dhe FSK-së, zëvendëskryeministri dhe ministri i Ministrisë së Drejtësisë Hajredin Kuçi, ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme Bajram Rexhepi, ambasadori i Kosovës në Uashington Akan Ismaili, atashu i sigurisë pranë ambasadës së Republikës së Kosovës në Uashington gjeneralbrigade Xhavit Gashi, atashu ushtarak i SHBA-ve në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, zyrtarë të lartë të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë si edhe afaristë e përfaqësues të shoqërisë civile nga Republika e Kosovës. Konferenca treditore i ka filluar punimet më 15 gusht 2012 dhe i

ka përfunduar më 17 gusht 2012. Konferenca është përqendruar në planet dhe synimet për të ardhmen në kuadër të Programit Shtetëror të Partneritetit Ajovë-Kosovë. Përfaqësues të qeverisë dhe udhëheqës të sektorit privat nga Kosova dhe Ajova, gjithashtu, kanë marrë pjesë dhe kanë diskutuar për mënyrat e bashkëpunimit konkret dhe intensiv.

Punimet e Konferencës i shpalli të hapura komandanti i Gardës Kombëtare të Ajovës gjeneralmajor Timothy Orr, i cili tha: "Është e lehtë për të zhvilluar pjesën ushtarake të misionit-një urdhër i lëshuar dhe zbatohet në praktikë, ndërsa zhvillimi i marrëdhënieve civile është sfidë tjetër e rëndësishme. Është e rëndësishme për të ndërtuar këto marrëdhënie. Kjo është ajo që ne jemi duke bërë këtu. Këto marrëdhënie mund të zhvillohen



duke takuar bashkë liderë të ndryshëm nga Kosova dhe Ajova".

Ndërsa zëvendëskryeministri i Qeverisë së Republikës të Kosovës dhe ministër i Ministrisë së Drejtësisë Hajredin Kuçi bëri një prezantim me temën: "Republika e Kosovës sot dhe në të ardhmen", e cila zgjoi interesim të madh tek të pranishmit, ku u fokusua në situatën politike, kushtet dhe mundësitë ligjore që ofron Kosova për investime si edhe falënderoi shtetin e

Ajovës e në veçanti Gardën Kombëtare të Ajovës, me të cilën Forca e Sigurisë së Kosovës ka marrëveshje bashkëpunimi që nga marsi i vitit 2011.

Në punimet e ditës së parë mori pjesë edhe guvernatori i shtetit të Ajovës, Terry Branstad. Zotëri Terry Branstad, pasi përshëndeti pjesëmarrësit në konferencë tha; "Ndoshta mënyra më e mirë për të bërë këto lidhje do të përqendrohet në pikat e forta të ngjashme të dy shteteve, shtetit të Ajovës dhe të Kosovës. "Ne duam

të bëjmë çdo gjë që është e mundur që marrëdhëniet në mes të Ajovës dhe Kosovës të zhvillohen edhe më tutje" tha guvernatori i Ajovës, z. Branstad.

Ndërsa ambasadori i Kosovës në Shtetet e Bashkuara, Akan Ismaili, tha se takimet e tilla, janë një mundësi e mirë për ndërtime dhe frymë bashkëpunuese. Ne mund të ndajmë me ju sfidat tona dhe planet për të ardhmen dhe të shohim se si mund të punojmë së bashku për të arritur këto qëllime," tha Ismaili.

## Ministri Çeku: Sukseset dhe sfidat e FSK-së drejt zhvillimit të saj

Në ditën e dytë të zhvillimit të punimeve të Konferencës për Programin Shtetëror të Bashkëpunimit Ajovë-Kosovë, u paraqitën ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, me temat: themelimi, sukcesi dhe sfidat e FSK-së.

Ministri Agim Çeku, në paraqitjen e tij, foli për aspektin politik të themelimit të FSK-së, zhvillimit të saj dhe objektivave të Ministrisë dhe Qeverisë për zhvillimin dhe modernizimin e strukturës së Forcës së Sigurisë të Kosovës. Ministri Çeku me këtë rast përmendi edhe faktin se misioni i FSK-së është i përcaktuar me pakon e Ahtisarit dhe se më deklarimin e përbushjes së kapaciteteve për FSK-në, do të krijohen mundësi për më shumë kompetenca dhe hapje të mundësive për integritet rajonale si dhe integritet në NATO.

Më tej, ministri i MFSK-së Agim Çeku ka vlerësuar shumë lartë angazhimin e Gardës Kombëtare të Ajovës në funksion të mbështetjes së ofruar për FSK-në. Ai tha se që nga marsi i vitit 2011, kur FSK-ja dhe Garda Kombëtare

e Ajovës kanë nënshkruar Programin e Partneritetit, rezultatet janë të dukshme dhe shumë konkrete. Ministri Çeku nga ana e tij shpali idenë për zhvillimin e FSK-së në një forcë moderne, efektive dhe profesionale. Në fund ministri Çeku, falënderoi posaçërisht gjeneralmajorin Timoti Orr, për angazhimin e tij, si komandant i Gardës Kombëtare të Ajovës për mbështetjen e gjithanshme që ka bërë deri më tani, për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në fjalën e tij, shpali të arriturat e FSK-së që nga viti 2009, vit kur edhe është themeluar FSK-ja. Po ashtu gjeneral Kastrati foli konkretisht për fushat e bashkëpunimit ndërmjet FSK-së dhe Gardës Kombëtare, për



mbështetjen që Garda e Ajovës, i ka ofruar FSK-së. Gjeneral Kastrati, më tej shtoi, se: "Aktualisht në FSK janë duke instruktuar disa oficerë të Ajovës, sidomos në zhvillimin e Korit të Nënoficerëve si shtylla e çdo organizimi ushtarak. Ai shprehu përkushtimin e tij, për vazhdimin e bashkëpunimit duke ofruar edhe fusha konkrete të identifikuar të cilat janë të vendosura si synime të tij, si komandant i

FSK-së.

Në konferencë me një ligjëratë u paraqitë edhe ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme Bajram Rexhepi, i cili u fokusua mbi çështje të sigurisë dhe funksionimit të ligjit në Kosovë.

Besa Kabashi Ramaj, këshilltare e lartë e ministrit të MFSK-së Agim Çeku, foli për temën: Rishikimi i Sektorit Strategjik të Sigurisë.

Temat e ligjëruar nga udhëheqësit kryesorë të institucioneve të

sigurisë së Kosovës, zgjuan interesimin e të pranishmëve të cilët edhe paraqiten një varg pyetjesh, gjithsesi për të fituar një pasqyrë të qartë të gjendjes në Kosovë.

Në këtë konferencë morën pjesë edhe disa ministra, qeveritarë dhe zyrtarë të disa ministrive të Qeverisë së Kosovës si ministri i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Blerand Stavileci etj.



# Përfundon me sukses ushtrimin i FSK-së "Reagim ndaj krizave" në Krivollak të Maqedonisë

**Shemi Veseli: FSK-ja është e përgatitur profesionalisht për reagim ndaj krizave**



FSK-ja për realizimin e këtij operacion mjaft kompleks ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme.

Skenari i ushtrimit për "Reagim ndaj krizave" ishte: Instituti Sizmologjik i Republikës së Maqedonisë, ka njoftuar se Republikenë e Maqedonisë e ka goditur një tërmet prej 6.7 shkallë të Rihterit me epiqendër në rajonin e Krivollakut në Negotin. Si pasojë e tërmetit, njoftohet për shumë objekte të rënuara, njëriç të ngujuar nën gërmaadha, shkatërim të infrastrukturës rrugore, energjetike, ujësjellës, nyjeve të komunikimit dhe rrjedhjeve të materieve të rrezikshme, aksidente në komunikacion etj.

Republika e Maqedonisë ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme dhe ka kërkuar ndihmë nga vendet e rajonit. Ndihmës i është përgjigjur edhe Republika e Kosovës, duke i ofruar një kontingjent me njësi të specializuara të Kërkim-Shpëtimit Urban dhe MKAB-së, për përballje me materiet e rrezikshme. Po ashtu Republika e Maqedonisë për zhvillimin e këtij operacioni i është ofruar ndihmë edhe me ekipe mjekësore, të komunikimit dhe me një kontingjent të Polcisë së Forcës.

Në mbështetje të autoriteteve maqedonase për zhvillimin e operacioneve emergjente, pas tërmetit që ka goditur këtë vend, kontingjenti i FSK-së, duke shfrytëzuar rrugët tokësore dhe mjeteve vetjake të transportit është dislokuar në territorin e Republikës së Maqedonisë, në Krivollak.

I tërë operacioni është zhvilluar në dy faza: në fazën e planifikimit dhe në fazën e realizimit të operacionit.

Komanda e Forcës Tokësore të



forcimi i marrëdhëneve në mes të Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ndërsa, komandanti i FSK-së gjeneralëjtënant Kadri Kastrati në fjalën e tij tha: kjo është një përvojë e mirë për pjesëtarët e FSK-së dhe, sipas tij objektivi i këtij ushtrimi është realizuar ashtu siç ishte planifikuar. Ne, gjatë këtij ushtrimi i kemi realizuar të gjitha procedurat standarde të mundshme si pikë e komunikimit, në mes Maqedonisë-Tiranës dhe Prishtinës.

"Qëllimi i FSK-së është arritur për arsye se kjo kompani i ka ushtruar të gjitha procedurat, standartet nga mobilizimi, planifikimi, kolona deri këtu, zbarkimi, ngritja e kampit dhe pas përfundimit të ushtrimit, urdhri për këthim në kazerma. Qëllimi i tyre ka qenë komunikimi strategjik, që ne e kemi arritur dhe i kemi vendosur pikat e komunikimit këtu në Krivollak, në Tiranë dhe në Prishtinë. Ky komunikim ka rjedhur sipas procedurave pa pengesa dhe kjo është një arritur shumë e madhe, që unë e vlerësoj si komandanti i FSK-së", ka thënë në fund gjeneral Kastrati.

Pjesë e ushtrimit të FSK-së kanë qenë edhe gjashhtë pjesëtarët e Gardës Kombëtare të Ajovës, të cilët kanë qenë së bashku me pjesëtarët e FSK-së, në realizimin e këtij ushtrimi. Kontingjenti i FSK-së pas përfundimit me sukses të ushtrimit "Reagim ndaj krizave" është kthyer në Kosovë, për të vazhduar me punë dhe aktivitetet e përditshme.

Pjesëtarët e Gardës Kombëtare të Ajovës, të cilët e kanë përcjellë ushtrimin që nga fillimi e deri në fund, janë shprehur të kënaqur me punën e njësive të specializuara të FSK-së.

danti i FSK-së gjeneralëjtënant Kadri Kastrati, gjeneralët Zymer Halimi dhe Nazmi Brahimaq, oficerët të KFOR-it, pjesëtarët të Gardës Nacionale të Ajovës, këshilltarë të Ekspit. Këshillues të

bashkëpunimi si forcë e përdorimit të bashkëpunimit në të ardhmen. FSK-ja tregoi se është e përgatitur me personat dhe pajisje të nevojshme për të zhvilluar këso

loj ushtrimesh me karakter ndërkombëtar për "Reagim ndaj krizave".

Këtë ushtrim të kontingjentit të FSK-së, në Krivollak, e kanë përcjellë: ministri Agim Çeku, koman-

planteve, angazhimeve si dhe vizionit për bashkëpunim në të ardhmen, ka dislokuar një kontingjent në Krivollak të Republikës së Maqedonisë, në mënyrë që bashkëpunimi dhe

FSK-së në këtë operacion i ka angazhuar njësitet e specializuara të dislokimiti parë i FSK-së, jashtë vendit, për këso loj ushtrimesh. Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës në bazë të

reajonit, më datë 27 gusht 2012, është dislokuar në Republikën e Maqedonisë me një kontingjent të madhësisë së një kompanie prej 120 pjesëtarësh të stërvitur dhe të pajisur për Reagim ndaj Krizave.

Zëvendësministri i Ministrisë për Forcën e Sigurisë të Kosovës Shemi Veseli, nga Kazerma e FSK-së "New Born", në Gjilan, përshëndeti të gjithë oficerët dhe ushtarët e FSK-së, të KFOR-it, të NATO-s dhe të Ajovës, para nistes së tij në ushtrimin ndërkombëtar "Reagim ndaj krizave" në Krivollak të Maqedonisë. "Sot është një ditë e shënuar për MFSK-në, për bashkëpunimin rajonal mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës, gjegjësisht midis Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë dhe Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Dislokimi i kontingjentit të

reajonit, më datë 27 gusht 2012, është dislokuar në Republikën e Maqedonisë me një kontingjent të madhësisë së një kompanie prej 120 pjesëtarësh të stërvitur dhe të pajisur për Reagim ndaj Krizave.





Komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Kadri Kastrati, vizitoi deminierët e FSK-së në Koshare

## FSK-ja pastron këtë vit mbi 70 mijë metra katrorë sipërfaqe të minuara



Ekipi i deminierëve në Koshare ka pastruar mbi 20 mijë m<sup>2</sup> dhe ka shkatërrua 29 mjete të pashpërthyer, si: mina, granata dore, eksploziv, projektilet etj. Për të përcjellë nga afër aktivitetin e ekipit të deminierëve të FSK-së, në Koshare, qëndroi komandanti i FSK-së gjeneralletenant Kadri Kastrati së bashku me zv. ambasadorin e Britanisë së Madhe Joe Preston, atashëun ushtarak të SHBA-së,

ku morën pjesë edhe oficerë të lartë të FSK-së, KFOR-it, NATO-s etj. Gjeneralletenant Kadri Kastrati dhe zv. ambasadori i Britanisë së Madhe Joe Preston, kanë përsëritur ekipin e deminierëve për punën e madhe që po bëjnë në pastrimin e minave dhe të mjeteve të tjera të pashpërthyer. Komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës Kadri Kastrati, ka

inkurajuar pjesëtarët e FSK-së, përkatësisht të kompanisë së çminimit për punën e madhe dhe humane, që po bëjnë në pastrimin e fushave të tëra nga minat dhe mjetet e tjera të pashpërthyer, të cilat kanë mbetur si pasojë e luftës nga ushtria e Serbisë. Nga këto mjete të pashpërthyer, deri më tani në Kosovë, kanë humbur jetën 114 qytetarë si dhe kanë pësuar lëndime fizike mbi 440 vetë, të cilët kanë mbetur

me pasojë për tërë jetën. Gjeneral Kastrati është shprehur i lumtur dhe se ndihet tejet kërenar me punën e deminierëve dhe në përgjithësi me profesionalizmin e tyre, ku vetëm falë këtij profesionalizmi, deri më tani asnjë pjesëtarë i FSK-së nuk ka pësuar as gërvishtjen më të vogël. Në fund gjeneral Kadri Kastrati kërkoi nga ekipi i deminimit që edhe më tutje të punojnë me përkushtim dhe me profesionalizëm, që sa më parë ta bëjnë pastrimin e të gjitha mjeteve të pashpërthyer në Kosovë, duke bërë kështu jetën e qytetarëve më të qetë dhe më të sigurt, kur dihet se "Ky vend ka qenë një vij

frontale ku është luftuar me forcat serbe, të cilat kanë lënë shumë mina që paraqesin rrezik të madh për të gjithë banorët e Kosovës". Kompania e Deminimit e FSK-së, gjatë këtij viti ka arrit të bëjë pastrimin e mbi 70 mijë m<sup>2</sup> të territorit të Kosovës dhe ka shkatërruar mbi 200 predha të llojeve të ndryshme, si: granata dore, mortaja, raketa, bombakasetë, mina të ndryshme etj. Kompania e Deminimit po vazhdon aktivitetin e saj në këto lokalitete: Në Hajvali, Komuna e Prishtinës, në Harilaq, Komuna e Fushë-Kosovës, në Ferizaj, si dhe të fushëbetejat e Koshares, Belincës etj.



## Delegacioni i Akademisë për Paqe dhe Siguri në Evropë i Austrisë vizitoi FSK-në

Një delegacion i gjerë i Akademisë për Paqe dhe Siguri në Evropë i Austrisë i prirë nga ING.MMag Gunther J. Rozenitz, zhvilloi një vizitë në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me ç'rast u pritën nga Komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Kadri Kastrati dhe shefi i shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri. Gjeneral Kastrati për delegacionin austriak bëri një prezantim të historikut të ngritjes dhe zhvillimit të Forcës së Sigurisë për këto vite që nga themelimi e deri më tani. Po ashtu komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Kadri Kastrati me theks te veçantë u ndalë në arritjen e Kapaciteteve të Plota Operacionale, strukturën e FSK-së, detyrat si edhe bashkëpunimin në vendet e rajonit. Interesimi i delegacionit austriak ishte edhe mbi të ardhmen e FSK-së si edhe perspektiva e FSK-së, për të cilën gjeneral Kastrati foli me optimizëm në bazë të parametrevave të vendosur dhe objektivave, si edhe krahas zhvillimeve politike në prag të



përfundimit të mbikëqyrjes së pavarësisë, si edhe pas rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë, priten detyra shtesë si edhe ndryshim i misionit të Forcës. Akademia për Paqe dhe Siguri në Evropë ka anëtarësi me profil ushtarak, shumica prej aktivistëve dhe veprimtarëve të saj janë me karrierë të oficerëve, të cilët e njohin mirë aspektin e

sigurisë, jo vetëm në Austri por edhe në rajonin e Ballkanit e më gjerë në Evropë. Në koordinim të vizitës së sotme një kontribut ka dhënë edhe bashkatdhetari ynë, Miftar Kastrati, udhëheqës i Institutit për Integritet, i cili ka iniciuar takimin dhe ka në plan gjetjen e fushave me të cilat mund të bashkëpunohet në të ardhmen

## Atasheu i ri ushtarak i Holandës u prit nga zëvendësministri Shemsi Veseli dhe gjenerali Gëzim Hazrolli

Zëvendësministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës, Shemsi Veseli dhe zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), gjeneral brigade Gëzim Hazrolli kanë pritë në takime të ndara, atashëun ushtarak në largim të Holandës, nënkolonel Ton Koedam dhe atashëun e ri, nënkolonel Jan Williem de Wolt. Vizita e atashëut të ri ushtarak të Holandës, nënkolonel Jan Williem de Wolt kishte për qëllim njohjen me punën e Ministrisë dhe të Forcës së

Sigurisë të Kosovës. Me këtë rast, zëvendësministri Veseli dhe gjeneral Hazrolli duke i uruar mirëseardhje në detyrë dhe duke i ofruar bashkëpunim atashëut të ri, e njoftuan atë edhe me të arriturat e FSK-së dhe me objektivat e saj për të ardhmen. Ata po ashtu falënderuan atashëun në largim, nënkolonel Ton Koedam, për bashkëpunimin e pakursyer që ka treguar gjatë detyrës së tij me FSK-në, si dhe për realizimin e shumë projekteve në Kosovë.



## Zvëndësministri i Punëve të Jashtme të Turqisë vizitoi Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës

Zvëndësministri për ministrinë e Forcës së Sigurisë të Kosovës Bejtush Gashi priti në ambientet e kësaj ministrie ambasadorin Naci Koru zëvendësministër i Punëve të Jashtme të Turqisë si dhe ambasadorin e Turqisë në Kosovë Songul Ozan. Gjatë këtij takimi zvëndësministri Gashi e njoftoi zvëndësministrin Koru për arritjet e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe punën e vazhdueshme të MFSK-së që Forca të arrijë që ti pranohen dhe miratohen Kapacitetet e Plota Operacionale. Po ashtu zvëndësministri i MFSK-së Bejtush Gashi e falënderoi zotëri Koru për mbështetjen e vazhdueshme për ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës në të gjitha aspektet,

duke përmendur kështu projektet dhe trajnimet e ndryshme që pjestarët e ushtrisë së Turqisë janë duke i zhvilluar për pjestarët e FSK-së.

Ndërkaq zvëndësministri Koru tha se është jashtëzakonisht i kënaqur me të arrituarit e FSK-së dhe se Turqia do të vazhdojë edhe më tutje thellimin e këtij bashkëpunimi si në aspektin politik po ashtu edhe në atë ushtarak.

Pjesëmarrës të këtij takimi ishin edhe drejtori i Departamentit për Politika dhe Plane, Haxhi Shala, drejtori për Bashkëpunim Ndërkombëtar, kolonel Ilir Qeriqi, si dhe përfaqësues të ambasadës Turke në Kosovë Ahnek Derehi, Ulvi Darendeli dhe Nora Cecelia.



## Dy kadete të FSK-së shkollohen në Akademinë Mbretërore Ushtarake-SANDHURST

Dy kadete të Forcës së Sigurisë së Kosovës po marrin pjesë në një shkollim njëvjeçar në Akademinë Ushtarake të Mbretërisë së Bashkuar SANDHURST. Përzgjedhjen e kadeteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës e ka bërë Ambasada Britanike. Kadetet e përzgjedhura janë; nëntoger Manushaqe Nura dhe nëntoger Mimoza Budeci, të cilat fillimisht do të kalojnë në një trajnimin tre-javor, në fazën paraprake, në kursin e gjuhës angleze në Akademinë Mbretërore Ushtarake; (në Shkollën e Gjuhëve të Mbrojtjes, Beaconsfield), pastaj për njëmbëdhjetë muaj do të ndjekin trajnimin në Akademinë Ushtarake Mbretërore, Sandhurst, për oficer, ku do të qëndrojnë deri më 8 shtator 2013. Ky trajnim është realizuar me ftesë formale nga Qeveria e Britanisë së Bashkuar dhe kjo do të jetë hera e parë, që Kosova ka dërguar dy kadete në Akademinë Ushtarake-Sandhurst.

Që nga viti 2009, qeveria britanike ka financuar pjesëmarrjen e kadeteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në kurset njëvjeçare në kuadër të trajnimit për oficer në Akademinë Mbretërore Ushtarake, Sandhurst. Çdo kurs zakonisht kushton rreth 60.000 funta për kadet. Akademia Mbretërore Ushtarake-Sandhurst është një nga akademitë më të vjetra ushtarake dhe më prestigjioze në botë. Ajo çdo vit përgatitë mbi 600 oficerë të rinj, për



ushtrinë britanike, ku së bashku kryejnë edhe një numër i vogël i studentëve të shteteve të ndryshme të botës, të cilët paraprakisht kanë kaluar nëpër fazën seleksionuese që të jenë pjesë e Akademisë Ushtarake. Konkurrenca për të gjitha vendet është jashtëzakonisht e madhe dhe regjimi rigoroz i trajnimit do të thotë se jo të gjithë do të diplo-

mojnë me sukses.

Për këtë arsye, vetë përzgjedhja e kadeteve të FSK-së është një arritje e konsiderueshme jo vetëm për kadetët, por edhe për FSK-në.

Të dy kadetet e FSK-së, Nura dhe Budeci që nga 18 gushti kanë filluar shkollimin në Akademinë Ushtarake në Mbretërinë e Bashkuar.

## Në Zhilivodë të Vushtrrisë nuk ka mbetje mortore

FSK-ja ka punuar në këtë projekt humanitar për tri vite, në tri faza, ku ka gërmuar mbi 86625 metra kub dhe, dhe ka kryer mbi 9757 orë pune. Qëllimi i saj ka qenë që me personel dhe mjete të tjera teknike të realizoj këtë projekt, për gjetjen e mbetjeve mortore.

Në përmbyllje të gërmimeve, sot morën pjesë përfaqësues të EULEX-it, të Qeverisë së Kosovës, Komisionit për Personat e Pagjetur, përfaqësues të Komisioneve përkatëse nga Serbia, përfaqësues të FSK-së, etj.

Kryetari i Komisionit për Personat e Pagjetur, Preng Gjetaj, tha se kemi punuar dhe gërmuar më shumë se tri vite, për zbulimin e 1300 personave të pagjetur-zhdukur, por sot, po e përmbyllim këtë projekt, pa rezultate, sepse nuk ka pasur mbetje mortore. Zotëri Gjetaj në emër të Qeverisë së Kosovës (FSK) për punët e kryera, departamentin e Mjekësisë Ligjore, EULEX-in dhe ambasadën e Norvegjisë e cila e ka mbështet projektin e Zhilivodës.

Projekti i gërmimit-hulumtimit në Zhilivodë ka qenë njëri ndër projektet më transparente deri më tani, ku të gjithë kanë pasur mundësi të marrin pjesë në përcjelljen e punimeve gjatë hulumtimit në këtë lokalitet, kjo ka ndodhur sepse Qeveria e



Kosovës është shumë e interesuar për zbardhjen e të gjitha rasteve që kanë të bëjnë me personat e zhdukur gjatë luftës, përfundoi fjalën e tij zotëri Gjetaj. "FSK-ja falë bashkëpunimit të mirë me

Institucionet vendore, EULEX-in dhe të tjerë, ka arrit që të gërmojë mbi 86625 metra kub dhe, kanë punuar mbi 9757 orë pune, në këtë lokalitet dhe sot, po i përfundojnë gërmimet. Është për ta përshëndetur

punën e pjesëtarëve të FSK-së, të cilët edhe përkundër thellësisë mbi 30 metra nën tokë, kanë gërmuar pa pasur as më të voglin problem dhe kjo flet për profesionalizmin e pjesëtarëve të Xhenios të FSK-së" tha në fund gjeneralbrigade Zymer Halimi, drejtor i Drejtorisë për Operacione të FSK-së.

Ndërsa, Krasimir Nikoolev, ushtrues i detyrës së bashkëkryesuesit (EULEX), në Departamentin e Mjekësisë Ligjore, tha se edhe përkundër gërmimeve nën 30 metra thellësi, nuk ka pasur mbetje mortore. Ai ka falënderuar njësitin e Xhenios të FSK-së, për punën profesionale të saj. "Hapësira që ishte lëndë e interesimit dhe e cila ishte përcaktuar në urdhrin e gjykatës përfshinte rreth shtatë mijë metra katrorë dhe përbëhej prej dymbëdhjetë minierave të thëngjillit të lidhura me tunele. Ato janë gërmuar të gjitha. Aty nuk u gjetën mbetje mortore të njerëzve", tha në fund Krassimir Nikolov.

Pasi ka falënderuar FSK-në, për punën profesionale dhe këmbëngulëse për gjetjen e personave të zhdukur, Arsim Gërxhaliu, drejtor i Departamentit të Mjekësisë Ligjore, tha se ne jemi shumë të interesuar për zbardhjen e fatit të gjithë personave të pagjetur, dëshmon edhe kjo sot, ku për një informatë jo të besueshme kemi bërë një punë kaq të madhe, që tri vite.





## FSK-ja intervenon për shuarjen e zjarreve në Kosovë

Forca e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht njësitet e specializuara të saj, gjatë ditëve të fundit kanë intervenuar në shumë vende në shuarjen e zjarreve që ka kapluar lokalitet si pasojë e temperaturave të larta dhe të faktorëve të tjerë.

Njësitet e zjarrëfikjes kanë intervenuar me sukses në Deçan, Isniq, Korreticë, Cernushë (Mitrovicë) etj. Njësitet profesionale të zjarrëfikjes të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) janë angazhuar me personel dhe makineri të rëndë në shuarjen e zjarreve që i kanë përfshirë shumë male në disa lokalitete.

Më 6 gusht, një njësit i FSK-së, me 8 pjesëtarë dhe me 2 automjete ka

intervenuar në fshatin Korreticë të Epërme, në Komunën e Drenasit. Ndërsa, më 7 gusht njësitet e zjarrëfikjes së FSK-së, kanë intervenuar në Bjeshkët e Deçanit, me 35 pjesëtarë dhe me 4 automjete të ndara në dy skuadra:

Në fshatin Cernushë të Komunës së Mitrovicës, ka intervenuar Batalioni i Dytë i Brigadës për Reagim të Shpejtë, me 13 pjesëtarë dhe 2 automjete. Gjithashtu, më 7 gusht ka intervenuar edhe një njësitë i Kompanisë së Zjarrëfikjes për shuarjen e zjarrit në varrezat e fshatit Isniq, Komuna e Deçanit, ku ishin të angazhuar 9 pjesëtarë edhe një automjet.

FSK-ja gjatë dy ditëve të fund ka angazhuar 106 pjesëtarë me gjithsej 15 automjete të rënda për shuarjen e zjarreve në Kosovë.

Forca e Sigurisë së Kosovës në raste emergjencash të shkaktuara nga zjarri, intervenon vetëm atëherë kur kapacitetet civile në nivel lokal dhe regjional nuk ia dalin ta sanojnë gjendjen dhe për këtë kërkojnë ndihmë, atëherë aktivizimi i FSK-së bëhet nëpërmjet Këshillit të Sigurisë së Kosovës me urdhër të Presidentit dhe Kryeministrit. FSK-ja, është reagues i parë në Deminim dhe Mbrojtje Kimike -Biologjike -Atomike(MKBAK).

## FSK-ja përfundoi projektin humanitar në Nekoc të Drenasit

Njësia e Xhenios që vepron në kuadër të Brigadës së Mbështetjes Operacionale të Forcës së Sigurisë të Kosovës, në organizim të Departamentit Civil-Ushtarak të MFSK-së, këto ditë ka realizuar edhe një projekt humanitar, në fshatin Nekoc të Drenasit, pastrimin e mbeturinave të ish-objektit të shkollës të demoluar gjatë luftës në Kosovë.

Njësia e Xhenios këtë projekt e ka filluar më 08 gushtë 2012 dhe e ka përfundua më 23 gusht 2012. Objekti ka pasur një sipërfaqe prej 780 m<sup>2</sup>, ndërsa Njësia e Xhenios e FSK-së, ka pastruar mbi 170 kamionë me mbeturina, gjithsej 2066 m<sup>3</sup>. Në përfundimin e punëve të

projektit në fshatin Nekoc, ka qëndruar për një vizitë punë edhe komandanti i Brigadës së Mbështetjes Operacionale (BMO), kolonel Ilaz Dërguti me bashkëpunëtorë i cili ka përshëndetur pjesëtarët e Xhenios, të cilët me përkushtim janë angazhuar në realizimin e këtij projekti humanitar. Kolonel Dërguti ka premtuar se edhe në të ardhmen Kompania e Xhenios e FSK-së, që ai drejton, do të angazhohet në projekte humanitare, kudo në Kosovë, për t'iu dalë në ndihmë qytetarëve tanë. Ai ka falënderuar pjesëtarët e xhenios për punën e palodhshme, si dhe drejtorin e shkollës dhe banorët e fshatit Nekoc, për bashkëpunim e mirë me FSK-në.



FSK-ja intervenoi edhe në Bjeshkët e Koritnikut

## Gjeneral Kastrati: Njësitet e FSK-së po angazhohen me të gjitha kapacitetet profesionale në shuarjen e zjarreve

Njësitë e zjarrëfikjes dhe të deminimit të FSK-së, gjatë muajit gusht, kanë marrë pjesë në shumë aksione për fikjen e zjarreve dhe heqjen e mjeteve të pashpërthyer, si në malin Koritnik të Komunës së Dragashit, në Koshare etj.

Njësitë e FSK-së, me një numër të madh pjesëtarësh dhe me autocisterna e makina transportuese si dhe me pajisje personale dhe mjete profesionale kundër zjarrit, kanë vepruar në Malin e Koritnik të Komunës së Dragashit, ku me një angazhim maksimal dhe profesional kanë arritur ta lokalizojnë zjarrin, në këtë komunë. Në vendin e ngjarjes, për një vizitë pune, ka qëndruar edhe komandanti i FSK-së gjeneralletnënt Kadri Kastrati për të parë nga afër aktivitetin e njësitëve të FSK-së si dhe për të bërë vlerësimin e punës dhe të gjendjes që po mbretëron në terren.

Komandanti i FSK-së gjeneral



Kastrati së bashku me kryetarin e Komunës së Dragashit, kanë vizituar vendin e ngjarjes, ku janë njoftuar për situatën e rëndë, si dhe për angazhimin maksimal dhe profesional të njësitëve të FSK-së. Situata raportohet të jetë tejet e rëndë, për shkak të rrezikut të shpërthimit të minave të mbetura nga lufta dhe rrezikut të shpërthimeve të tyre. Si pasojë e zjarrit ka pasur edhe shumë shpërthime të minave.

Kjo gjendje e bënë edhe më të vështirë punën duke pasur parasysh edhe mbrojtjen e jetës së pjesëtarëve të FSK-së dhe pjesëmarrësve tjerë në aksion.

Çdo ditë njësitë e FSK-së së bashku me njësitë e zjarrëfikjes civile dhe qytetarët janë duke vazhduar me përpjekje maksimale për të fikur zjarrin. Me gjithë situatën e krijuar në terren, FSK-ja ka arrit ta lokalizojë zjarrin në malet e Koritnikut.